

STATUTIINDRYSHUAR

I

“SHOQATËS SË ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË”

Datë[●]

Tabela e Lëndës

HYRJE	4
NENI I. FORMA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI	4
PARAGRAFI 1.01.....	4
NENI II. SELIA	4
NENI III. SHTRIRJA TERRITORIALE	4
NENI IV. KOHËZGJATJA	4
NENI V. QËLLIMI I SHOQATËS	4
PARAGRAFI 5.01.....	4
NENI VI. FUSHA E VEPRIMTARISË	5
NENI VII. BURIMET FINANCIARE	5
PARAGRAFI 7.01.....	5
PARAGRAFI 7.02.....	5
NENI VIII. KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË	6
PARAGRAFI 8.01.....	6
PARAGRAFI 8.02.....	6
NENI IX. VITI FINACIAR	6
NENI X. ANËTARËSIA NË SHOQATË	6
PARAGRAFI 10.01 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE.....	7
PARAGRAFI 10.02 HUMBJA E ANËTARËSISË	7
NENI XI. STURKTURA ORGANIZATIVE E SHOQATËS	7
PARAGRAFI 11.01 ORGANET DREJTUESE	7
PARAGRAFI 11.02 ASAMBELJA E PËRGJITHSHME.....	8
PARAGRAFI 11.03 FUNKSIONIMI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME.....	8
PARAGRAFI 11.04 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme	8
NENI XII. PRESIDENTI I NDERIT	9
NENI XIII. KËSHILLI DREJTUES	9
PARAGRAFI 13.01.....	9
PARAGRAFI 13.02 KOMPETENCAT.....	10
PARAGRAFI 13.03 Mbledhja e Këshillit Drejtues	10
PARAGRAFI 13.04 EMËRIMI, SHKARKIMI DHE NDRYSHIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES.....	11
PARAGRAFI 13.05 KARAKTERI VULLNETAR.....	11
PARAGRAFI 13.06 MARRËVESHJET E VEÇANTA DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE.....	11
NENI XIV. KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES	12
PARAGRAFI 14.01.....	12
PARAGRAFI 14.02 KOMPETENCAT.....	12
PARAGRAFI 14.03 PËRFAQËSIMI LIGJOR.....	12
PARAGRAFI 14.04 ADMINISTRATA	13

PARAGRAFI 14.05 ZËVENDËSKRYETARI DHE SEKRATARI I PËRGJITHSHËM.....	13
PARAGRAFI 14.06.....	13
NENI XV. PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE DHE PUNONJËSVE	13
NENI XVI. MARRËDHËNIET E PUNËS	13
NENI XVII. BASHKIMI DHE NDARJA	13
NENI XVIII. SHPËRNDARJA E SHOQATËS	13
PARAGRAFI 18.01 SHPËRNDARJA.....	13
PARAGRAFI 18.02 LIKUIDATORI.....	13
NENI XIX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	14

HYRJE

“**Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë**” është person juridik shqiptar i regjistruar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.[●], datë [●], themeluar nga [●], bazuar në Urdhërin Nr. 3 datë 25.06.1991 të Ministrit të Ndërtimit (këtu e në vijim referuar si “**Shoqata**”).

Këshilli Drejtues i Shoqatës, i përbërë nga [●], me qëllim përbushjen sa më efektive të objektivave e funksioneve të tij duke i konsideruar ndryshimet si të nevojshme dhe të arsyeshme, i propozoi Asamblesë së Përgjithshme miratimin e Statutit të Ndryshuar të Shoqatës, e cila e miratoi atë në datën [●]me përmbajtjen si vijon:

NENI I. FORMA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI

Paragrafi 1.01

Forma juridike e kësaj Organizate Jofitimprurëse është“Shoqatë”me emrin “**Shoqata e Arkitektëve tëShqipërisë** ”dhe akronim **SH.A.SH.**

Sigla e Shoqatës bashkë me simbolin e saj të veçantëështë paraqitur në një fletë, pjesë përbërësetë këtij Statuti.

Emri dhe Sigla e Shoqatës duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del ngaShoqata.

NENI II. SELIA

Selia e Shoqatës ndodhet në [●] kutia postare [●]. Selia mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Drejtues.

NENI III. SHTRIRJA TERRITORIALE

Shoqata zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo mund tëthemelojë degë të saj në qendër ose nëçdo njësi tjetër administrativo-territoriale të Shqipërisë, njëkohësisht mund të themelojë degë ose filiale edhe jashtë territorit të Shqipërisë.

NENI IV. KOHËZGJATJA

Shoqata themelohet dhe do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohë të pacaktuar.

NENI V. QËLLIMI I SHOQATËS

Paragrafi 5.01

Shoqata ka për qëllim të lehtësojë dhe të zhvillojë takime ndërmjet arkitektëve dhe urbanistëve pa dallim përgatitjeje profesionale, të krijojë mardhënie miqësore, mirëkuptimi dhe respekti reciprok, të lejojëarkitektët të ballafaqojnë idetë dhe konceptet e tyre, të përfitojnë nga përvoja e njëri-tjetrit, të thellojnë njohuritë e tyre sidhe të reflektojnë vlera të larta morale dhe etike.

Në mënyrë specifike Shoqata ka për qëllim:

- a) Të sigurojë komunikimin ndërmjet arkitektëve për qëllime profesionale;
- b) Të lidhet me organizatat e ndryshme brenda dhe jashtë vendit, që kanë të bëjnë me profesionin e arkitektit;
- c) Të rrisë besimin tek arkitektët dhe kompetencat e tyre duke kërkuar nga anëtarët e Shoqatës një nivel të lartë në planin moral e profesional;
- d) Të mbështesë zhvillimin e arkitekturës dhe urbanistikës si dhe aplikimin praktik të tyre për të mirën e përgjithshme;
- e) Të mbështesë bashkëpunimin e arkitektëve me disiplinat e tjera, me profesione të ndryshme që kanë lidhje me ndërtimin dhe planifikimin, duke nënvizuar rëndësinë e punës së arkitektit dhe detyrimet e tij ndaj të tjerëve;
- f) Të përkrahë prirjet bashkëkohore të përgatitjes së përgjithshme për konceptet e hapësirës dhe të dhënies së materies, formes arkitekturore si dhe t'i mbështesë dhe të marrëmasat perkatese për këtë qëllim;
- g) Të kujdeset në vazhdimësi që roli kulturor e shoqëror i arkitektit dhe urbanistit të njihen nga organizmat zyrtarë e që profesioni i tyre të zërë një vend dinjitoz në shoqëri;
- h) Të japë ndihmesën e mundshme për përcaktimin e kushteve të nevojshme për shkollimin dhe ushtrimin e profesionit të arkitektit;
- i) Të nxisë formimin bashkëkohor të arkitektit të lehtësojë shkëmbimet e përvojës brenda e jashtë vendit si dhe të organizojë pjesëmarrjen në simpoziume ndërkombëtare të arkitektëve dhe takimet me studiues të ndryshëm.

NENI VI. FUSHA E VEPRIMTARISË

Aktivitetet dhe programet kryesore të kësaj Shoqate janë të lidhura me organizimin e kolokiumeve, simpoziumeve, seminareve, mbledhje dhe ekspozita sidhe veprimtari të tjera në nivel kombëtar e ndërkombëtar në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.

NENI VII. BURIMET FINANCIARE

Paragrafi 7.01

Burimet financiare janë si më poshtë:

- a) Kuotat e anëtarëve;
- b) Kuotat për pjesëmarrjen në aktivitete;
- c) Donacione private ose nga institucione qeveritare dhe joqeveritare që do të mbështesin realizimin e qëllimit të organizatës;
- d) Të ardhura nga pasuri të luajshme ose të paluajshme në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- e) Te ardhura te realizuara nga aplikime per projekte, brenda apo jashte vendit, ne institucione publike apo subjekte private; si dhe
- f) Çdo veprimtari tjetër ekonomike e lejuar me ligj.

Paragrafi 7.02

Shoqata nuk pranon donacione ose financime të shoqëruara me kushte që do të kufizonin lirinë e saj të vendimmarrjes ose të veprimit.

NENI VIII. KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURISË

Paragrafi 8.01

Shoqatabën shpenzime ekskluzivisht për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilin është krijuar si dhe për drejtimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së saj.

Të gjitha të ardhurat që Shoqata fiton nëpërmjet veprimtarisë së saj ekonomike përdoren vetëm për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë Statut dhe në Aktin e Themelimit.

Paragrafi 8.02

Fondet financiare ose ato materiale të dhuruara nga donatorë të ndryshëm me destinacion përdorimi të përcaktuar duhet të përdoren pa ndryshuar destinacionin e tyre me përjashtim të rasteve kur kjo është e pamundur apo kur është dhënë miratimi nga vetë donatorët. Marrëdhëniet e Shoqatës me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

Shoqata akordon një fond të posaçëm për udhëtime nga ana e përfaqësuesve të lartë në dobi dhenë funksion të qëllimeve të Shoqatësidhe për botimin e revistës “*Arkitektura*”.

NENI IX. VITI FINACIAR

Viti financiar i Shoqatës është viti kalendarik 1 Janar deri ne 31 Dhjetor. Bilanci duhet të përfundohe brenda 3 mujorit të parë të vitit pasardhës.

Këshilli Drejtues i paraqet Asamblesë së Përgjithshme projekt-buxhetin vjetor të paktën 15 ditë para mbledhjes në të cilën do të diskutohet.

NENI X. ANËTARËSIA NË SHOQATË

Anëtarësimi në Shoqatë bëhet mbi bazën e vullnetit të lirë pa kufizime, me pranimin e statutit të Shoqatës dhe me pagesën e kuotizacionit.

Anëtarë të Shoqatës janë:

- a) Anëtarët aktivë që mund të jetëçdo person i diplomuar nëfushën e Arkitekturës, Urbanistikës dhe çdo specialitet i lidhur më këto profesione;
- b) Anëtarët e Nderit të cilët janë persona të pranuar, bazuar në një arritje ose kontribut të shquar në fushën e qëllimeve të Shoqatës, me emërimin e tyre nga mbledhja e Këshillit Drejtues;
- c) Anëtarët e asociuar, të cilët mund të jenëkompani, shoqëri tregëtare, organizata me kontribute në realizimin e misionit të Shoqatës.

Anëtarët e rinj pranohen me vendim të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues miraton rregulla për pranimin e anëtarëve në degët e Shoqatës, nëse do të themelohen të tilla në të ardhmen.

Anëtarësia nuk mund të tjetërsohet dhe as të kalohet me anëtrtrashëgimisë.

Çdo anëtar kur e çmon të arsyeshme mund të largohet nga Shoqata, duke njoftuar për këtë me shkrim organin drejtues. Anëtari që largohet nga Shoqata nuk ruan asnjë të drejtë ekonomike mbi pasurinë e Shoqatës.

Vetëm anëtarët aktivë kanë të drejtë të marrin pjesë në votim në Asamblenë e Përgjithshme ose të përfitojë nga shërbimet me tarifa të reduktuara ku Shoqata është organizatore.

Paragrafi 10.01 Të Drejtat dhe Detyrimet e Anëtarëve

Anëtarët kanë të drejtë:

- a) Të njihen me programet e Shoqatës dhe të bëjnë sugjerime për to, të informohen rregullisht për aktivitetet e Shoqatës;
- b) Të jenë aktivë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve të ndërmarra nga Shoqata;
- c) Të zgjidhen;
- d) Të zgjedhin;
- e) Të rekalmojnë qëllimet e Shoqatës dhe të marrin pjesë në aktivitetet e saj;
- f) Të veprojnë në përputhje me statutin e Shoqatës;

Pagesa e kuotave nuk është e detyrueshme për pensionistët dhe personat që nuk janë në marrëdhënie pune.

Paragrafi 10.02 Humbja e Anëtarësisë

Anëtarësia humbet:

- a) Me anë të dorëheqjes;
- b) Kur nuk paguhet kuotizacioni rregullisht(viti pasardhës);
- c) Me anë të përjashtimit për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve në përputhje me vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme.

Përjashtimi i anëtarëve bëhet me vendim të Këshillit Drejtues.

Ankimimi bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

NENI XI. STURKTURA ORGANIZATIVE E SHOQATËS

Paragrafi 11.01 Organet Drejtuese

Organet Drejtuese të Shoqatës janë:

- Asambleja e Përgjithshme;

– Këshilli Drejtues.

Paragrafi 11.02 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues, i cilipërbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit.

Secili anëtar i Asamblesë së Përgjithshme do të ketë të drejtën e një vote, kur është pranishëm ose i përfaqësuar me prokurë. Në rast se votat dalin të barabarta për marrjen e një vendimi, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

Çdo anëtar i Asamblesë së Përgjithshme mund të përfaqësohet me prokurë. Anëtari duhet të ketë prokurë me shkrim dhe ta paraqesë para fillimit tëçdo mbledhjeje. Një person mund të përfaqësojë aq anëtarë sa është përcaktuar në prokurë. Në prokurë duhet të jenë të përcaktuara të drejtat që jepen, deri nëç’kufij jepet kjo prokurë dhe ky akt depozitohet rregullisht në Sekretarinë e Shoqatës.

Paragrafi 11.03 Funkionimi i Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat si vijon:

- a) Ndryshimin e Statutit dhe të Aktit të Themelimit sidhe akteve të tjera normative të Shoqatës;
- b) Transformimin, ndarjen ose bashkimin e Shoqatës me shoqata të tjera;
- c) Fushat dhe programet e veprimtarisë dhe kërkon e kontrollon rregullisht realizimin e tyre;
- d) Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit,
- e) Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Shoqatës dhe shpenzimet për vitin në vazhdim;
- f) Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës;
- g) Emëron/shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues;
- h) Zgjedh Presidentin e Nderit;
- i) Vendos për vetshpërndarjen e Shoqatës dhe destinacionin e pasurisë së mbetur;
- j) Çdo çështje tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj;

Paragrafi 11.04 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- a) **Numri i Mbledhjeve.** Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit por mund të mblidhet dhe më shumë se një herë kur kjo kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të saj ose nga Kryetari i Këshillit për raste emergjente.
- b) **Kuorumi.** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është e vlefshme me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.

- c) **Vendimet.** Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me 2/3 e numrit të anëtarëve të pranishëm në rastin e ndryshimit të Statutit, transformimit, ndarjes apo bashkimit të Shoqatës dhe vetëshpërndarjes. Çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
- d) **Kryetari i Këshillit.** Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet nga Këshilli me vendimin e shumicës së anëtarëve që e përbëjnë atë. Kompetencat e Kryetarit të Këshillit kufizohen vetëm për organizimin e mbledhjeve, thirrjen, drejtimin dhe mbarëvajtjen e saj. Në rastet kur kryetari nuk është i pranishëm në mbledhje ai zëvendësohet përkohësisht nga një anëtar tjetër i Këshillit, i zgjedhur nga Këshilli për këtë qëllim.
- e) **Njoftimet.** Thirrja e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike jo më vonë se dy javë nga dita e mbledhjes. Njoftimi dërgohet në adresën e deklaruar në selinë e Shoqatës nga secili anëtar. Ftesa duhet të përmbajë dhe rendin e ditës së mbledhjes. Mosmarrja e njoftimit për shkak të ndryshimit të adresës është përgjegjësi e vetë anëtarit. Mbledhja zhvillohet edhe kur nuk është respektuar afati i njoftimit me kusht që prezent në mbledhje të jenë të gjithë anëtarët që e përbëjnë Këshillin. Anëtarët që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në mbledhje detyrohen të njoftojnë Kryetarin jo më vonë se 5 ditë para datës së mbledhjes. Anëtarët duhet të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të pakten një në tre herë.
- f) **Proces-verbali.** Proces-verbali i mbledhjes mbahet nga njëri prej anëtarëve të Këshillit. Kjo detyrë bëhet me qarkullim ndërmjet anëtarëve. Proces-verbale të mbledhjes dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të mbahen në regjistrat përkatës dhe me rregull kronologjik dhe në fund proves-verbali firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës ndërsa Vendimi i zbardhur nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe personi që e ka mbajtur atë.

NENI XII. PRESIDENTI I NDERIT

President Nderi mund të zgjidhet në shenjë mirënjohjeje person me reputacion dhe kredibilitet të lartë, për shërbime të rëndësishme e të veçanta ndaj Shoqatës dhe për veprimtari të shquar në sferën e arkitekturës dhe urbanistikës.

Kandidati për president nderi duhet të fitojë me shumicë të cilësuar në Asamblenë e Përgjithshme. Ai merr pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, por nuk ka të drejtë vote.

NENI XIII. KËSHILLI DREJTUES

Paragrafi 13.01

Veprimtaria e Shoqatës do të drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe jo më pak se pesë anëtarë.

Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë katër vjeçare dhe kanë të drejtë të rizgjidhen.

Anëtarët e Këshillit Drejtues shkarkohen sipas rasteve dhe mënyrave të përcaktuara në këtë Statut.

Paragrafi 13.02 Kompetencat

Këshilli Drejtues ka kompetencat si vijon:

- a. Propozon orientimet e përgjithshme të veprimtarisë së Shoqatës dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- b. Propozon programin vjetor të punës dhe ia paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- c. Propozon ndryshimin e Statutit, Aktit të Themelimit dhe çdo akti tjetër normativ të Shoqatës;
- d. Harton projekt buxhetin vjetor të Shoqatës;
- e. Organizon mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe i rekomandon asaj për miratim kandidaturat e pershtatshme në rastë zgjedhësh;
- f. Emëron/shkarkon Kryetarinsidhe kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimtarisë së tij;
- g. Krijon komitete të posaçme apo organizma të tjera vendimmarrëse ose këshillimore;
- h. Autorizon direkt persona për të kryer detyra të caktuara.
- i. Miraton propozimin dhe autorizon pjesëmarrjen në aplikime për projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në subjekte private apo institucione publike;

Paragrafi 13.03 Mbledhja e Këshillit Drejtues

- g) **Numri i Mbledhjeve.** Këshilli Drejtues mblidhet të paktën një herë në 3 muaj por mund të mblidhet dhe më shumë se një herë kur kjo kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit ose nga Kryetari i Këshillit për raste emergjente.
- h) **Kuorumi.** Mbledhja e Këshillit Drejtues është e vlefshme me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij.
- i) **Vendimet e Këshillit.** Vendimet e Këshillit Drejtues merren shumicën e thjeshtë të numrit të anëtarëve të pranishëm.
- j) **Kryetari i Këshillit.** Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit. Kompetencat e tij kufizohen vetëm për organizimin e mbledhjeve, thirrjen, drejtimin dhe mbarëvajtjen e saj. Në rastet kur kryetari nuk është prezent në mbledhje ai zëvendësohet përkohësisht nga një anëtar tjetër i Këshillit i zgjedhur nga Këshillit për këtë qëllim.
- k) **Njoftimet.** Thirrja e Anëtarëve të Këshillit bëhet me shkrim ose në mënyrë elektronike jo më vonë se dy javë nga dita e mbledhjes. Njoftimi dërgohet në adresën e deklaruar në selinë e Shoqatës nga secili anëtar. Ftesa duhet të përmbajë dhe rendin e ditës së mbledhjes. Mosmarrja e njoftimit për shkak të ndryshimit të adresës është përgjegjësi e

vetë anëtarit. Mbledhja zhvillohet edhe kur nuk është respektuar afati i njoftimit me kusht që prezent në mbledhje të jenë të gjithë anëtarët që e përbëjnë Këshillin. Anëtarët që për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në mbledhje detyrohen të njoftojnë Kryetarin jo më vonë se 5 ditë para datës së mbledhjes. Anëtarët duhet të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të pakten një në tre herë.

- l) **Proces-verbali.** Proces-verbali i mbledhjes mbahet nga njëri prej anëtarëve të Këshillit. Kjo detyrë bëhet me qarkullim ndërmjet anëtarëve. Proces-verbale të mbledhjes dhe vendimet e Këshillit Drejtues duhet të mbahen në regjistrat përkatës dhe me rregull kronologjik. Në fund të mbledhjes proces-verbali firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës ndërsa Vendimi i zbardhur nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

Paragrafi 13.04 Emërimi, Shkarkimi dhe Ndryshimi i Anëtarëve të Këshillit Drejtues

- a) **Emërimi.** Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet nga Asambleja e Përgjithshme. Emërimi bëhet pas kërkesës së paraqitur nga vetë kandidati, e cila shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe i propozohet Asamblesë së Përgjithshme.
- b) **Shkarkimi.** Shkarkimi i anëtarit bëhet nga Asambleja e Përgjithshme me propozim të Këshillit Drejtues kur anëtari:
 - Kryen me dashje veprime në dëm të Shoqatës;
 - Nuk respekton rregullat për pjesëmarrjen në mbledhjet e Këshillit Drejtues;
 - Shkel Statutin apo Aktin e Themelimit;
 - Shpallet fajtor me vendim të gjykatës për kryerjen e krimeve të rënda.Anëtari i propozuar për shkarkim nuk merr pjesë në votim por ka të drejtë të mbrojë veten e tij para Këshillit Drejtues. Për shkarkimin e anëtarit nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- c) **Ndryshimi.** Ndryshimi i anëtarit bëhet nga mbledhja e Këshillit kur anëtari i Këshillit:
 - i. Jep dorëheqjen,
 - ii. Vdes apo është i paaftë për të vepruar.

Përgjegjësia e Anëtarit të Këshillit që largohet është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjerë për veprimtarinë e tij të kryer deri në çastin e largimit.

Paragrafi 13.05 Karakteri Vullnetar

Anëtarët e Këshillit Drejtues në të gjitha rastet ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë vullnetare dhe pa kundërshperblim. Punonjësit e paguar nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të Këshillit Drejtues. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij por gjithmonë patë drejtë vote.

Paragrafi 13.06 Marrëveshjet Veçanta dhe Zgjidhja e Konflikteve

Marrëveshjet ndërmjet Shoqatës dhe një anëtarit të Këshillit Drejtues, Kryetarit dhe një punonjësi të saj lejohen vetëm nëse: a) lidhen për të përmbushur një qëllim të Shoqatës, b) janë të drejta dhe c) janë në përputhje me vlerën e tregut. Marrëveshjet duhet të miratohen nga Këshillit.

Personi i interesuar përjashtohet nga votimi. Në raste mosmarrëveshesh të ndaluara kur kushtet e mësipërme nuk janë zbatuar Këshilli mund të anulojë marrëveshjen dhe të ngrejë padi për dëmshpërblim në gjykatë.

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të Këshillit, ndërmjet tyre dhe Këshillit apo ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin e rregullat e Shoqatës. Në të kundërt çështja zgjidhet nga Gjykata.

NENI XIV. KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Paragrafi 14.01

Këshilli Drejtues zgjedh Kryetarin me shumicë të cilësuar, i cili kamandat tre vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje deri në dy herë.

Paragrafi 14.02 Kompetencat

- a) Kryetari merret me veprimtarinë përditshme dhe ekzekutimin e programeve të vendosura nga Këshilli Drejtues;
- b) Kryen veprime bankare me llogarinë e Shoqatës, lidh dhe nënshkruan marrëveshje dhe kontratanë emër të Shoqatës në përputhje me vendimet dhe miratimin e Këshillit Drejtues;
- c) Emëron, shkarkon dhe ngarkon me detyra brenda funksionit anëtarët e administratës (kur katë tillë) dhe kontrollon zbatimin e tyre, merr persona në punë sipas vendeve vakante të përcaktuara nga Këshilli;
- d) Kontrollon mbarëvajtjen administrative të Shoqatës dhe harton lidhur me të raporte të hollësishme të cilat ia paraqet Këshillit Drejtues çdo 6 muaj ose më shpesh kur i kërkohet nga Këshilli, në mbledhjen vjetore të Këshillit ai paraqet raportin përfundimtar vjetor dhe atë financiar;
- e) Informon Këshillin Drejtues për çështjet që vlerëson se duhet t'i paraqiten Këshillit, përfshi dhe ato që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, Aktit të Themelimit, Rregullores, harton projekte të reja, lidhur me aktivitetin e Shoqatës dhe ia paraqet për miratim Këshillit Drejtues, në raste urgjente, merr masat e domosdoshme dhe menjëherë informon Këshillin;
- f) Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit Drejtues me të drejtë vote;
- g) Mban përgjegjësi para Këshillit Drejtues për të gjithë veprimtarinë që kryen në funksionin dhe detyrat e tij.

Paragrafi 14.03 Përfaqësimi Ligjor

Kryetari është përfaqësuesi ligjor i Shoqatës me palët e treta. Ai përfaqëson Shoqatën në marrëdhëniet me personat juridikë ose fizikë, vendas dhe të huaj, institucionet shtetërore në të gjitha llojet e marrëdhënieve juridike që Shoqata lidh me to. Ai përfaqëson Shoqatën dhe në proceset gjyqësore kur është palë në gjykim dhe sipas rastit cakton një avokat për ndjekjen e çështjeve.

Paragrafi 14.04 Administrata

Administrata e Shoqatës drejtohet nga Kryetari. Organizimi bazë i Strukturës së Administratës me propozohet nga Kryetari miratohet nga Këshilli Drejtues.

Paragrafi 14.05 Zëvendëskryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm

Zëvendëskryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet për çdo mandat pesë vjeçar, me të drejtë zgjedhje deri në dy herë.

Paragrafi 14.06

Shoqata mund të krijojë dhe organe të tjera këshillimore si Bordi i Anëtarëve të Nderit apo komitete të ndryshme për mbarëvajtjen e organizimit të Shoqatës.

NENI XV. PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ORGANEVE DREJTUESE DHE PUNONJËSVE

Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e Shoqatës përgjigjen për detyrimet e Shoqatës ndaj të tretëve vetëm në rastet kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

NENI XVI. MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës së Shoqatës rregullohen konform dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI XVII. BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqata mund të transformohet, ndahet ose bashkohet me Shoqata të tjera sipas kushteve dhe mundësive që parashikon ligji dhe vendimeve të Këshillit Drejtues.

NENI XVIII. SHPËRNDARJA E SHOQATËS

Paragrafi 18.01 Shpërndarja

Shpërndarja e Shoqatës bëhet në rastet si vijon:

- a) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Antëtarëve të saj;
- b) Kur qëllimi i Shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;
- c) Kur Shoqata ushtron veprimtari të jashtëligjshme;
- d) Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Sipas rasteve dhe mënyrës së parashikuar në ligj, Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e Shoqatës. Në këtë rast të gjitha kompetencat që ka Këshilli Drejtues i kalojnë Gjykatës sipas procedurës së përcaktuar në ligj.

Paragrafi 18.02 Likuidatori

Në rast se Shoqata duhet të shpërndahet, Këshilli Drejtues cakton dhe një apo disa persona si Likuidatorë, të cilët në të gjitha rastet kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi pasurinë dhe

përfaqësimin e Shoqatës që nga dita e emërimit të tyre deri në përfundim të dhurimit. Likuidatorët veç të tjerash vlerësojnë pasurinë e mbetur dhe kujdesen që ajo të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti, Gjykata ose ligji. Raporti Përfundimtar i përgatitur nga Likuidatorët miratohet nga Këshilli Drejtues dhe më pas ky i fundit kërkon çregjistrimin e Shoqatës në Gjykatë. Kur Këshilli Drejtues refuzon miratimin e Raportit Përfundimtar, çështja zgjidhet nga Gjykata.

NENI XIX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Përsa nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohen, dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi dhe ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “**Për Organizatat Jofitimprurëse**” apo ligje të tjera në fuqi, të aplikueshme sipas rastit.

Statuti i Ndryshuar datë [●], miratohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe nënshkruhet nga Këshilli Drejtues i përbërë nga [●].

Duke filluar nga momenti i regjistrimit në Gjykatë, ky Statut zëvendëson plotësisht Statutin e mëparshëm.

Për Shoqatën

“SHOQATA E ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË”

[●]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. ___Rep.

Nr. ___Kol.

VËRTETIM NOTERIAL

Sot, mëdate [●] , përpara meje, Noterit/res [●], noteri i Dhomës së Noterëve Tiranë u paraqit personalisht:[●], lindur më[●], shtetas shqiptare me Nr. ID [●] me banim në [●], madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, të cilët në prezencën time nënshkruan Statutin e Ndryshuar bashkëngjitur këtij vërtetimi dhe Unë, Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.